



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

*Data 19.07.2019*

**Për:** Bashkimin e Operatorëve ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” shpk dhe “ED KONSTRUKSION” shpk

**Adresa:** Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë

\* \* \*

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur”

**Referenca e procedurës:** REF-23958-05-27-2019

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Kompletimi i nënsistemit të Qendrës së Kontrollit të Trafikut me kamera televizive me qark të mbyllur dhe integrimi i tij me nënsistemet e tjera të qendrës”

**Kohëzgjatja e kontratës:** Afati kohor për realizimin e investimit do të jetë 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**Fondi limit:** 55.509.571 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa tvsh

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 04.07.05.2019, ora 11.00

**Publikime të mëparshme:** Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 22 datë 03 Qershor 2019.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “EUROGJICI-SECURITY” shpk NUIS K31929010K**  
Vlera e ofertës– 0 (zero) lekë **Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**

**2. Operatori ekonomik “S.A.S(Special Albania Security)”shpk, NUIS K31526053M**  
Vlera e ofertës– 0 (zero) lekë **Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**

### **3. Operatori ekonomik “ATOM” shpk**

**NUIS L22203042N**

Vlera e ofertës pa TVSH– 55.467.007,4 (pesëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatë, presje katër) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 59.616.432,94 (pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e dy, presje nëntëdhjetë e katër) lekë

### **4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” shpk NUIS K01625001C dhe “ED KONSTRUKSION” shpk NUIS K61625001I**

Vlera e ofertës pa TVSH– 54.971.236,9 (pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë, presje nëntë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 59.087.484,28 (pesëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër, presje njëzetë e tetë) lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Operatori ekonomik “EUROGJICI-SECURITY” shpk, NUIS K31929010K**
- 2. Operatori ekonomik “S.A.S(Special Albania Security)”shpk, NUIS K31526053M**
- 3. Operatori ekonomik “ATOM” shpk, NUIS L22203042N**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

#### **1. Operatori ekonomik “EUROGJICI-SECURITY” shpk**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**Eurogjici Security**” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik dhe oferten ekonomike të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik “**Eurogjici Security**” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### **2. Operatori ekonomik “S.A.S (Special Albania Security)”shpk**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**S.A.S Special Albania Security**” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik dhe oferten ekonomike të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik “**S.A.S Special Albania Security**” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### 3. Operatori ekonomik "ATOM" shpk

Operatori ekonomik "Atom" shpk ka paraqitur në sistemin elektronik (SPE) bilancin e tre viteve 2016, 2017, 2018, vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore dhe Formularin e ofertës ekonomike sipas shtojcës 1 dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër teknik ekonomik dhe ligjor të kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik shoqëria "Atom" shpk s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik "COMMUNICATION PROGRESS" shpk dhe "ED KONSTRUKSION" shpk**, me adresë: Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 54.971.236,9 (pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë, presje nëntë) lekë pa tvsh dhe 59.087.484,28 (pesëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër, presje njëzetë e tetë) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.07.2019.**

**Ankesa:** Nuk është paraqitur asnjë ankesë për klasifikimin përfundimtar.